



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1034 Prot.

Tiranë, më 27. 06. 2019

V E N D I M

Nr. 79, Datë 27. 06. 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 69, datë 05.06.2019, e shtetasit F. Xh., kundër Shërbimit Spitalor Korçë dhe Qendrës Shëndetësore Maliq, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të gjendjes shëndetësore*¹. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi shpjegon se është banor i Bashkisë Maliq, Njësia Administrative Pojan, Fshati Zvezdë. Sipas ankuesit, bashkëshortja e tij për shkak të gjendjes shëndetësore në të cilën gjendet, është e detyruar të marrë shërbimin e dializës një herë në dy ditë në orën 07:00 të mëngjesit, në Spitalin Rajonal të Korçës. Ankuesi pretendon se mbështetur në Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë Nr. 469, datë 30.08.2010 “*Për sigurimin e transportit për të sëmurët që trajtohen me dializë*”, Shërbimi Spitalor Korçë, ka detyrimin t’i sigurojë transportin të sëmurëve që trajtohen me dializë. Në këto kushte, për shkak të pamundësisë për të dërguar bashkëshorten me anë të një automjeti privat për kryerjen e shërbimit të dializës, zgjidhja e vetme ka qënë transporti me anë të autobuzit të linjës Zvezdë-Korçë. Problematika që parashtron ankuesi, lidhet me faktin se autobuzi i linjës Zvezdë-Korçë nisat në orën 08:00 të mëngjesit dhe e përshkon rrugën deri në Korçë për rreth 40 minuta. Në këtë kuadër, bashkëshortja e tij nuk shkon në kohën dhe orarin e përcaktuar për të marrë shërbimin e dializës. Pavarësisht faktit se nga ana e Shërbimit Spitalor Korçë i rimburohet transporti në shumën 2300-2400 lekë në muaj, ai kërkon nga ana e këtij institucioni dhe Qendrës Shëndetësore Maliq, që t’i vihet në dispozicion një mjet transporti ambulancë, në mënyrë që

¹ Mbështetur në Vërtetimin Mjekësor lëshuar nga DiaVita Korçë dt. 12.06.2019, ankuesja vuan nga sëmundje Renale Kronike Stadi V, Polikistoze Renale, Osteodistrofia Renale, Anemi Sekonadare.

bashkëshortja e tij të marrë shërbimin e dializës në kohë dhe në kushte të përshtatshme për gjendjen shëndetësore të saj.

Sipas ankuesit, ai i është drejtuar disa herë Shërbimit Spitalor Korçë dhe Prefektit të Qarkut Korçë, për sigurimin e transportit nëpërmjet një autoambulace të bashkëshortes së tij në qendrën e dializës në Korçë, por nuk ka marrë asnjë zgjidhje deri tani. Ankuesi pretendon se në fshatrat Gollobërdë, Pojan dhe Zvezdë të Njësisë Administrative Pojan, janë 6 persona që marrin shërbimin e dializës në Korçë dhe për asnjë prej tyre nuk i sigurohet transporti për në qendrën e dializës, ndërsa të sëmurëve nga Bashkia Pogradec apo Bilisht, i sigurohet transporti falas nga spitalet e këtyre bashkive.

Përsa më lart, ankuesi pretendon se, bashkëshortja e tij, Gj. Xh. dhe të sëmurët që vijnë nga Njësia Administrative Pojan, në raport me të sëmurët të cilët vijnë nga bashki të tjera të Prefekturës së Korçës, si Pogradeci apo Bilishti, trajtohen në mënyrë diskriminuese nga ana e Shërbimit Spitalor Korçë dhe Qendra Shëndetësore Maliq.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, F. Xh. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese dhe të rekomandojë vendosjen e transportit falas për shërbimin e dializës.

Në këtë kontekst, përmendim se Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë ka dërguar në adresë të ankuesit, si përgjigje të kërkesës së tij, përkatësisht shkresën nr. 1028 prot., datë 17.06.2019, ku citohet se: “...sipas përgjegjëses së Qendrës së Hemodializës DiaVita, në Korçë ka 56 pacientë që marrin këtë shërbim. Në Spitalin e Korçës disponohen 9 autoambulanca për të gjithë aktivitetin e Spitalit për shërbim paraspitalor, dërgim në qendrat Terciare. Nga ana e Drejtorisë së Spitalit në bazë të Urdhërit Nr. 469, datë 30.08.2010 “Për sigurimin e transportit për të sëmurët që trajtohen me dializë”, këtyre pacientëve ju sigurohet pagesa për shpenzime udhëtimi sipas tarifave shtetërore...”

Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë, bashëkngjitur shkresës së sipërcituar, ka vënë në dispozicion të ankuesit kopje të përgjigjes së Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (në vijim QKUK), ku ndër të tjera sqarohet se shërbimi i dializës nuk është urgjencë dhe për këtë spitalet paguajnë shërbimin e transportit publik për çdo pacient të dializës. Nga QKUK sqarohet se spitalet nuk duhet të heqin nga shërbimi autoambulanca e caktuara për urgjencën paraspitale, pasi një pacient që bën dializën veç transportit duhet të pritët nga autoambulanca për 4 orë deri në përfundim të shërbimit të dializës. Pra, në këtë kuptim nuk është e mundur që të vendoset për çdo pacient nga një autoambulancë. Në këto kushte, pacientëve u është gjetur zgjidhja duke i paguar biletën e transportit publik nga ana e spitaleve dhe shërbimi i transportit për pacientët e dializës i sigurohet me autoambulancë vetëm atyre që janë të paralizuar dhe nuk mund të lëvizin vetë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Referuar Udhërit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 469, datë 30.08.2010 “Për sigurimin e transportit për të sëmurët që trajtohen me dializë”, parashikohet se: *“1. Transporti nga banesa në qendrat e dializës dhe anasjelltas, i të sëmurëve me insuficiencë renale kronike, që trajtohen me dializë, të përfshihet në ofrimin e shërbimit, për këtë kategori të sëmurësh. 2. Drejtoria spitalit e çdo rrethi, bazuar në listën e përcaktuar nga qendra ku ofrohet shërbimi i*

dializës, siguron transportin e të sëmurëve nga vendi i banimit, në qendrën e dializës dhe anasjelltas, nëpërmjet automjeteve të transportit të spitalit, apo atyre të shërbimit urban, publik apo privat (furgon, autobus), sipas përcaktimit të bërë nga drejtori i spitalit. 3. Drejtorja e spitalit, në rastin e transportit me automjetet e transportit të shërbimit urban, të rimburojë koston e transportit, në masën e tarifave të përcaktuara për funksionimin e shërbimit urban-publik, bazuar në biletat e paraqitura nga të sëmurët e rrethit të tyre...”.

Përsa më lart dhe mbështetur në parashtrimet e bëra në ankesë, ankuesi ka ngritur pretendimin se subjektet ndaj të cilëve ka paraqitur ankesë, nuk i është dhënë shërbimi i kërkuar. Në këtë kuptim dhe referuar dokumentacionit bashkëngjitur ankesës, si dhe shpjegimeve të dhëna në ankesë, F. Xh. nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë, i rimburohet shërbimi i transportit nga vendi i banimit deri në qendrën e dializës. Gjithashtu, nga ana e F. Xh. nuk pretendohet për asnjë moment që nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë apo Qendrës Shëndetësore Maliq, nuk i është siguruar shërbimi i nevojshëm i dializës për bashkëshorten e tij.

Referuar më sipër, F. Xh. nuk ka vënë në dispozicion asnjë informacion, provë apo indicie, me anë të së cilës të argumentojë trajtimin në mënyrë më pak të favorshme apo diskriminues nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë apo Qendrës Shëndetësore Maliq, por ankesën e bërë e ka mbështetur vetëm në kërkesën për të dërguar në qendrën e dializës bashkëshorten me anë të autoambulancave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë. Pra, F. Xh. nuk ka paraqitur asnjë informacion apo argument që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të krijojë bindjen e trajtimit të tij në mënyrë më pak të favorshme për një nga shkaqet e parashikuara në Ligjin nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 33, pika 4/ç të tij, parashikon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”.

Në përfundim, duke analizuar në tërësi ankesën Nr. 69, datë 17.06.2019, të F. Xh., Komisioneri gjykon se, në rastin konkret në mungesë të informacionit të mjaftueshëm për shqyrtimin e saj, ankesa nuk mund të pranohet dhe t’i nënshtrohet procedurave të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 69, datë 17.06.2019, së F. Xh., pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONER

(Shkaku: Gjendja shëndetësore)

(Fusha: Shërbime)